

ani, jemi me juve”, ndërkaq njëri nga ta u përgjigj “përse atëherë po gjuani, kur jeni me neve?” Atëherë, Siniša u nis matanë lumit, në drejtim të tyre. Përderisa po i afrohej burrave të armatosur me uniforma, ata i kthyen armët ndaj tij. E morën, e futën në xhip dhe vazhduan të shtënin ndaj miqve të Sinišës, të cilët atëherë ikën nga vendi i ngjarjes. Nga ajo ditë, nuk ka kurrfarë njo-huri për Sinišën. Zhdukja e Veselinut është regjistruar në listën e KNKK-së me numër rendor YUK-050001-01, ndërkaq ajo e Sinišës me YUK-050016-01.

**Burimet:** deklarata B.L, FDH-462; deklarata D.L, FDH-463; deklarata Z.L, FDH-5524; deklarata B.L, FDH-971; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; SMIP, *Teroristički...*, III, 89, 965; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

## Dragan (Trajan) Milić

(21.12.1961, serb nga Nerodimja e Poshtme/Donje Nerodimlje, komuna e Ferizajt/Uroševac, punëtor, dy fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Dragani me origjinë ishte nga Ferizaj/Uroševac, ndërkaq me bashkëshorten Oliveren dhe djemtë Slavišën dhe Sinišën jetonin në Nerodime të Poshtme/Donje Nerodimlje. Punonte në ndërmarrjen tregtare *17 nëntor*. Ka qenë pjesëtar i forcave rezervë të MPB-së së Serbisë. Dragani ka pësuar më **27.07.1998**, nga ora 13:00, përderisa e mbante rojën në pyll përmbi fshatin **Nerodime e Epërme/Gornje Nerodimlje**. E kanë varrosur dy ditë më vonë në varrezat e Nerodimes së Poshtme/Donje Nerodimlje.

**Burimet:** SMIP, *Teroristički...*, III, 427, 935; KMKMRF, *Personat...*, FDH-10832; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), EX.P320.12, FDH-7996; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 43; *Dnevnik od 22. do 28. jula*, Ilustrova politika, FDH-32215; *Pripadnici Ministarstva unutrašnjih poslova - žrtve albanskog terorizma u 1998. godini*, na http://www.srbija-info.yu/vesti/1999-02/19/9769.html, FDH-31078.

## Maksut (Ajet) Qafleshi

(23.09.1960, shqiptar nga Bellobradi/Belobrod, komuna e Dragashit/Dragaš, shofer, katër fëmijë)

Maksuti ka qenë i punësuar si vozitës

në kompaninë *Teuta impex* në Bellobrad/Belobrod [Dragash/Dragaš]. Me bashkëshorten Xhyzerijen i kishin vajzat Jehonën dhe Diellen dhe djemtë Jetmirin dhe Mërgimin.

Në datën **23.08.1998**, Maksuti u nis në rrugë zyrtare për në Beograd, për të transportuar nga atje miellin që kompania e tij e kishte porositur. Më punëtorin e ndërmarrjes Refik Sadikajn ata u nisën nga ora 17:00. Dy orë më vonë, në fshatin **Gërllicë/Grlica**, një grup prej gjashtë policëve serb e kanë ndaluar makinën e tyre. I nxorën Maksutin dhe Refikun jashtë. Katër policë e rrihnin Maksutin, ndërkaq dy të tjerë i mbanin tutat e armëve të drejtura ndaj Refikut. Maksuti u thoshte se ai ishte vetëm shofer i thjesht, por policët e shanin me nënë dhe e akuzonin se ishte nisur për të sjell miell për UÇK-në. Keqtrajtimi i rëndë fizik ka zgjatur për afro dhjetë minuta. Pastaj, policët i lanë Maksutin dhe Refikun në rrugë. Vendasit e çuan Maksutin në ambulancën *Nëna Terezë/Majka Tereza*, ku i dhanë ndihmën e parë. Pastaj, një mjek dhe një infermiere e çuan në spitalin e Prishtinës/Priština. Ka dhënë shpirt nga gjakderdhja e brendshme në të njëjtën mbrëmje. Ditën e nesërme, pas obduksionit, i vëllai Idajeti e ka marr trupin e Maksutit dhe e ka kthyer në fshat. Varrimi i Maksutit është bërë po atë ditë në varrezat e Bellobradit/Belobrod.

**Burimet:** deklarata Xh.Q, FDH-37122; FHP, *Haški tribunal, Suđenje Slobodanu Miloševiću*, XX, 9; HRW, *Shkeljet...*, 71, FDH-31132; *Yet Another Albanian Dies od Serb Police Torture*, pasqyra e lajmeve, KIC, 24.08.1998, FDH-29504.

## Ramiz (Shukri) Ukësmajli

(28.12.1974, shqiptar nga Jezerci/Jezerce, komuna e Ferizajt/Uroševac, bujk, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Ramizi merrej me bujqësi. Jetonte në bashkësi familjare me prindërit Miradin dhe Shukrijen, vëllezërit Naimin, Xhevatin, Esatin, Sabriun, Sylejmanin, Ademin dhe motrën Fatimen në shtëpinë familjare në Jezerc/Jezerce. Ka aderuar në UÇK më 21.07.1998. Njësitë i tij ka qenë i stacionuar